



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.60

2005

24 korrik

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i GJK nr.15, datë 13.7.2005	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.344, datë 9.6.2004 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si antikushtetues.....	2209
Vendim i GJK nr.16, datë 13.7.2005	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.400, datë 20.3.2003 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.1129, datë 27.5.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si antikushtetuese.....	2210
Vendim i GJK nr.17, datë 18.7.2005	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.17, datë 10.3.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si antikushtetues.....	2212
Vendim i GJK nr.18, datë 19.7.2005	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.304, datë 13.01.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si antikushtetues.....	2218
Vendim i GJK nr.19, datë 19.7.2005	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.470, datë 15.4.2002 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.1034, datë 3.6.2003 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhoma e këshillimit), si antikushtetuese	2221
Vendim i GJK nr.20, datë 20.7.2005	Me objekt shfuqizimin i vendimeve nr.98, datë 18.9.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës; nr.172, datë 16.9.2003 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe nr.146, datë 2.3.2004 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si antikushtetuese.....	2223

VENDIM
Nr.15, datë 13.7.2005

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i“ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i“ “
Kujtim Puto	Anëtar i“ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i“ “
Petrit Plloçi	Anëtar i“ “
Sokol Sadushi	Anëtar i“ “
Kristofor Peçi	Anëtar i” “

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 27.5.2005, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.28 Akti që i përket:

KËRKUES:FATMIR TUSHA, përfaqësuar nga avokatët Agim Hoxha e Fatmir Gjika, me prokurë.

SUBJEKTI I INTERESUAR:PROKURORIA E PËRGJITHSHME, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.344, datë 9.6.2004 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42/1, 131/f e 134/g të Kushtetutës.

Kërkuesi pretendon se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka zhvilluar proces të parregullt për këto shkaqe:

1. Nuk është vënë në dijeni, sipas ligjit, për rekursin e prokurorit ndaj vendimit të gjykatës së apelit që e pushoi çështjen në ngarkim të tij;
2. Nuk ka pasur dijeni për gjykimin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë dhe për rrjedhojë nuk është mbrojtur me avokat;
3. Shkelja e këtyre të drejtave ka cenuar parimin e kontradiktoritetit në gjykim, gjë që e bën procesin të parregullt.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin Kristofor Peçi, përfaqësuesit e kërkuesit dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Me vendimin nr.55, datë 25.6.2002, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë ka deklaruar fajtor kërkuesin Fatmir Tusha për krimin e vrasjes me dashje në rrethana cilësonjëse, mbetur në tentativë dhe në bazë të nenit 79/dh të Kodit Penal e dënon me 20 vjet burgim; deklarimin fajtor të tij për kundërvajtje penale të mbajtjes pa leje të armës së gjuetisë dhe në bazë të nenit 280 të Kodit Penal e ka dënuar me 3 muaj burgim. Në bashkim të dënimeve, kërkuesi është dënuar me 20 vjet burgim.

Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr.314, datë 6.11.2003, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së rrethit në dy herë kanosje, sipas nenit 84 të Kodit Penal dhe e pushoi çështjen për shkak se procedimi nuk mund të vazhdojë. Në zbatim të ligjit "Për amnistinë", kjo gjykatë prishi vendimin dhe pushoi çështjen për armëmbajtje pa leje.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, që shqyrtoi çështjen mbi rekursin e prokurorit, me vendimin objekt kërkesë, vendosi ndryshimin e vendimit të gjykatës së apelit përse i përket cilësimit ligjor të veprës, si vrasje me dashje mbetur në tentativë dhe në bazë të nenit 79/dh të Kodit Penal e dënon kërkuesin me 10 vjet burgim.

Gjykata Kushtetuese, duke marrë parasysh rrethanat e çështjes, vlerëson se pretendimet e

kërkuesit për shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor sipas kriterëve të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, janë të bazuara dhe për rrjedhojë kërkesa e tij duhet të pranohet.

Nga materialet e dosjes, të administruara në gjykim, nuk rezulton të ketë ndonjë dokument apo veprim që të vërtetojë se të gjykuarit apo mbrojtësit e tij t'i jetë njoftuar rekursi i prokurorit. Një qëndrim i tillë bie në kundërshtim me kërkesat e nenit 414 të Kodit të Procedurës Penale, që detyron gjykatën që ka dhënë vendimin t'i komunikojë aktin e ankimit palës tjetër. Shkelja e këtij detyrimi ligjor e ka privuar kërkuesin edhe nga realizimi i së drejtës së mbrojtjes në Gjykatën e Lartë, sepse ai nuk është vënë në dijeni se çështja e tij do të shqyrtohej nga kjo gjykatë. Këto shkelje të vazhdueshme të normave kushtetuese e ligjore kanë cenuar të drejtën për t'u dëgjuar e për t'u mbrojtur, çka e bën procesin të parregullt në kuptimin kushtetues.

Gjykata Kushtetuese duke iu referuar edhe praktikës së saj të mëparshme disa vjeçare ku është mbajtur i njëjti qëndrim për shkelje të kësaj natyre dhe duke e konfirmuar atë, thekson se zbatimi i standardeve të përcaktuara nga Kushtetuta dhe Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, në procesin penal, është një domosdoshmëri dhe kërkesë për të afirmuar shtetin ligjor. Sipas praktikës së Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, çdo cenim i të drejtave të individit, duhet të jetë objekti i një kontrolli efektiv i kryer nga gjyqësori duke ofruar garancinë më të mirë për pavarësi, paanësi dhe procedurë korrekte.¹

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/f e 134/g të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e 77 të ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.344, datë 9.6.2004 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM

Nr.16, datë 13.7.2005

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i“ “
Kristofor Peçi	Anëtar i“ “
Kujtim Puto	Anëtar i“ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i“ “
Petrit Plloçi	Anëtar i“ “
Sokol Sadushi	Anëtar i“ “

me sekretare Arbenka Lalice, në datat 28.2.2005 dhe 15.4.2005, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.21 Akti, që i përket:

KERKUES:FATBARDHA ALIZOTI, përfaqësuar nga avokat Viktor Konomi, me prokurë.

¹ . Shih çështjen Klass dhe të tjerë kundër Gjermanisë, v.6.9.78

SUBJEKTE TË INTERESUARA: 1. BARDHYL METULI, në mungesë.
2. SABAUDIN, ARJANA E ALI METULI, përfaqësuar nga avokat Arqile Nini, me prokurë.
OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetuese të vendimeve nr.400, datë 20.3.2003 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.1129, datë 27.5.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Për shfuqizimin si antikushtetuese të vendimeve të mësipërme, kërkesja ka parashtruar këto shkaqe:

- Në shqyrtimin e kërkesës ankimore, paraqitur nga pala e paditur, nuk është vënë në dijeni nga Gjykata e Apelit Tiranë për datën e për pasojë nuk ka marrë pjesë në shqyrtimin gjyqësor;
- Gjykata e apelit kishte shkaqe që të shtynte shqyrtimin e çështjes, gjë që nuk e ka kryer;
- Në gjykimin e rekursit në Gjykatën e Lartë, ka marrë pjesë një gjyqtare, e cila kishte marrë pjesë në gjykimin e çështjes në gjykatën e apelit.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Alfred Karamuço, përfaqësuesit e palëve, si dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Kërkesja Fatbardha Alizoti, mbi bazën e testamentit të lënë nga nëna, ka regjistruar si pronë të saj një banesë dhe një kopësht. Ajo ka ngritur padi kundër Bardhyl, Sabaudin, Merxhivan, Arjan e Ali Metuli, duke kërkuar pushimin e cenimit të pronësisë, si dhe lirim të sipërfaqeve të zëna. Ndërkohë të paditurit, kanë ngritur kundërpadi, ku kanë kërkuar të njihen pronarë për sipërfaqe të caktuara toke.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.3519, datë 18.9.2002, ka pranuar pjesërisht padinë, si dhe ka rrëzuar kundërpadinë. Kundër këtij vendimi kanë bërë ankim të paditurit dhe Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.400, datë 20.3.2003, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së rrethit duke rrëzuar padinë e Fatbardha Alizotit dhe pranuar kundërpadinë.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.1129, datë 27.5.2004, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së apelit.

Në tërësinë e këtyre proceseve e vendimeve gjyqësore konkrete, Gjykata Kushtetuese nuk gjen elemente të procesit të parregullt ligjor, ashtu siç pretendohet nga kërkesja.

Vërtetohet se në vendimin e gjykatës së rrethit ka pasur një gabim material lidhur me vendndodhjen e disa shtesave ndërtimi pa leje, të cilat duheshin prishur. Pa përfunduar këto procedura të korrigjimeve materiale, gjykata e apelit ka shpallur ditën dhe orën e gjykimit të kërkesës ankimore të të paditurve Bardhyl Metuli etj., (kopje e së cilës i është dorëzuar paditëses) duke kryer normalisht detyrimet që rrjedhin nga neni 460 i Kodit të Procedurës Civile.

Është fakt, që në shqyrtimin e ankimit në gjykatën e apelit nuk ka marrë pjesë si paditësja ashtu dhe përfaqësuesi i saj. Kërkesja këtë mungesë e argumenton me faktin se shqyrtimi i çështjes në shkallën e dytë nuk mund të bëhej pa u korrigjuar gabimet materiale të vendimit gjyqësor, konform nenit 312 të Kodit të Procedurës Civile. Gjykata Kushtetuese konstaton se në këtë dispozitë, si dhe në tërësi në Kodin e Procedurës Civile, nuk ka ndonjë rregull të vendosur sipas të cilit, korrigjimi i gabimeve me karakter teknik të përbëjë shkak për shtyrjen apo pezullimin e gjykimit të ankimeve ndaj këtij vendimi. Për më tepër, neni 312 i Kodit të Procedurës Civile nuk vendos afat për korrigjimet e as ndonjë kusht pezullues, përkundrazi, nga vetë përmbajtja e dispozitës del e qartë se korrigjimi nuk ka afat dhe nuk lidhet me fatin e çështjes.

Në këto kushte, mospjesëmarrja e kërkeses dhe e përfaqësuesit të saj në Gjykatën e Apelit Tiranë, nuk vjen për shkaqe që varen nga gjykata e për rrjedhojë kjo e fundit nuk ka zhvilluar një proces të parregullt ligjor. Gjykata Kushtetuese ka tashmë jurisprudencë të konsoliduar sipas së cilës, procesi i parregullt gjyqësor duhet kërkuar para së gjithash në veprimet e gjykatave, në faktin se sa dhe si ato kanë respektuar detyrimet kushtetuese dhe ligjore për të garantuar të drejtat e qytetarëve në një proces gjyqësor.

Kërkesja ka parashtruar si shkelje të parimit të procesit të rregullt ligjor edhe pjesëmarrjen e një gjyqtareje në Gjykatën e Lartë në shqyrtimin e rekursit, në një kohë kur po kjo gjyqtare ka qenë

pjesëmarrëse, e për më tepër relatore në Gjykatën e Apelit Tiranë, në shqyrtimin e çështjes. Gjykata Kushtetuese konstaton se në gjykatën e apelit, gjyqtarja nuk ka marrë pjesë në shqyrtimin e themelit të çështjes, por për kërkesën për ndreqjen e gabimit material. Në këto kushte, nuk vërtetohen rastet e cenimit të paanësisë së gjyqtarit e për pasojë, shkak për përjashtimin e tij sipas neneve 72-74 të Kodit të Procedurës Civile.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131/f dhe 134/g të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, si dhe në nenin 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM

Nr.17, datë 18.7.2005

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 12.11.2004, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.25 Akti që i përket:

KËRKUES: HEKTOR QIRJAKI, MUHAMET HATIA, SHKËLQIM AKULLI E ADEM DRACI, përfaqësuar nga avokat Arqile Nini, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: 1. SPIRO ZËRI, përfaqësuar nga avokatët Maksim Haxhia e Amalia Zëri, me prokurë.

2. SHOQËRIA “SERVCOM” SHA, FIER, përfaqësuar nga juristi Andius Olldashi, me autorizim.

3. KOMISIONI I KTHIMIT DHE I KOMPENSIMIT TË PRONAVE, pranë qarkut Tiranë, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.17, datë 10.3.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartës.

BAZA LIGJORE: Nenet 33/1, 42/1, 131/f e 134/g të Kushtetutës, si dhe nenet 27-30 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

Kërkesit kanë parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin si antikushtetues të vendimit të mësipërm:

1. Vendimi është marrë në dhomën e këshillimit. Çështja duhej të shqyrtohej në seancë gjyqësore me praninë e të gjitha palëve, për t'u dhënë mundësinë për të shprehur pretendimet dhe kundërshtimet për provën e re të paraqitur dhe pastaj të vendoste gjykata. Ky pretendim mbështetet edhe në praktikën e Gjykatës Kushtetuese dhe konkretisht në vendimin nr.6, datë 26.2.2003.

2. Në kundërshtim me kërkesat e neneve 442 e 447 të Kodit të Procedurës Civile kërkesa për rishikim e bërë nga pala tjetër, nuk u është njoftuar kërkuessve, duke shkelur kështu parimin e kontradiktoritetit në gjykim, parashikuar në nenet 19 e 20 të Kodit të Procedurës Civile.

Përfaqësuesit e subjekteve të interesuara, kanë parashtruar:

1. Kërkuessit nuk legjitimohen për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese për faktin se gjykata e apelit ka vendosur pushimin e shqyrtimit në lidhje me ta, vendim që nuk është kundërshtuar prej tyre.

2. Me vendimin e rishikimit çështja nuk është gjykuar në themel. Ai është një vendim i ndërmjetëm që e kalon çështjen për rishqyrtim duke u dhënë mundësi palëve të riballafaqohen nën dritën e fakteve të reja.

3. Në dhomën e këshillimit nuk thirren palët. Për këtë, ka edhe praktikë të Gjykatës Kushtetuese.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjo i relatorin Kristofor Peçi, përfaqësuesit e kërkuessve, të subjekteve të interesuara dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Sarandë me vendimin nr.199, datë 26.3.2001, ka vendosur pranimin e padisë së shoqërisë "Servcom" sh.a. (me persona të tretë kërkuessit Hektor Qirjaqi, Adem Draçi, Muhamet Hatia e Shkëlqim Akulli), duke shfuqizuar vendimin nr.272, datë 8.2.1996 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, përse i përket njohjes së pronësisë së trashëgimlënësve Jorgji e Vasil Zëri, mbi një ndërtesë dy katëshe në qytetin e Sarandës, ish-zyrat e naftës, pronë e palës paditëse dhe të sipërfaqes së truallit prej 271.6 m² në funksion të objektit.

Gjykata e Apelit Gjyrokastër, me vendimin nr.374, datë 17.7.2001, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë në lidhje me pranimin e padisë së paditësit për anulimin e vendimit të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe prishjen e vendimit e pushimin e gjykimit për personat e tretë.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.483, datë 4.3.2003, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit, Gjyrokastër.

Personi i interesuar Spiro Zëri, ka paraqitur pranë Gjykatës së Lartë kërkesën për rishikim të vendimeve të mësipërme. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.17, datë 10.3.2004, në dhomën e këshillimit, ka vendosur pranimin e kërkesës për rishikim, prishjen e vendimeve të lartpërmendura dhe kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Sarandë.

Në rrethanat që paraqitet çështja, Gjykata Kushtetuese çmon se pretendimet e ngritura nga subjekti i interesuar, që kanë të bëjnë me legjitimitimin e kërkuessve dhe shterimin e mjeteve ligjore, duhet të merren në shqyrtim fillimisht, pasi nga mënyra e zgjidhjes së tyre varet nëse shkaqet e ngritura nga kërkuessit për proces jo të rregullt do t'i nënshtrohen ose jo kontrollit kushtetues.

1. Sipas neneve 131/f e 134.2 të Kushtetutës, individët mund t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese për shkelje të të drejtave kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre, dhe pasi të jenë shterur të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave të tyre. Pikërisht, në këto dy aspekte është pretenduar nga subjekti i interesuar se kërkuessit nuk mund të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, sepse sipas tyre, gjykata e apelit ka vendosur pushimin e gjykimit për kërkuessit dhe këta nuk e kanë kundërshtuar vendimin.

Gjykata Kushtetuese vë në dukje se, sipas rrethanave të çështjes rezulton se kërkuessit, me cilësinë e personit të tretë në gjykim, kanë pasur interes të njëjtë me paditësin, Shoqërinë "Servcom", në drejtim të objektit dhe zgjidhjes së çështjes, e kanë mbështetur këtë të fundit dhe kanë paraqitur kundërrekurs ndaj rekursit që ka paraqitur pala tjetër, subjekti i interesuar.

Një qëndrim i tillë i kërkuessve motivohet nga fakti se ata, duke qenë qiramarrës në banesën që ishte pronë e paditësit, shoqëria "Servcom" kanë bërë privatizimin e apartamenteve që kishin në përdorim, duke qenë të interesuar për të mbrojtur këtë të drejtë të tyre.

Në kundërrekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, kërkesit mbështetnin plotësisht vendimin e gjykatës së apelit si të bazuar në prova e në ligj. Por ky fakt, nuk u heq atyre të drejtën për të ushtruar kërkesë në Gjykatën Kushtetuese përderisa pas vendimit të dhënë nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, i cili ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së apelit, çështja është vënë në lëvizje nga pala tjetër dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka pranuar në dhomë të këshillimit kërkesën për rishikim duke shfuqizuar vendimet e mëparshme. Shfuqizimin e këtyre vendimeve pa i vënë në dijeni kërkesit për një fakt të tillë, këtyre të fundit u cenohet një e drejtë e fituar me vendim të formës së prerë. Është ndryshimi i gjendjes juridike të krijuar, shoqëruar me shkeljen e pretenduar të së drejtës për një proces të rregullt që i legjitimon kërkesit për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese në bazë të kërkesave të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Për rastin në shqyrtim, Gjykata Kushtetuese thekson se interesi që kanë kërkesit është i ligjshëm, pasi e drejta e fituar është cenuar me një vendim tjetër të Gjykatës së Lartë pa i vënë në dijeni për gjykimin e rishikimit. Në kuptim të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit kjo përbën një bazë legjitime për kërkimin dhe ushtrimin e kontrollit kushtetues për të ndrequr shkeljen e pretenduar. Në konceptin e gjykimit kushtetues, për çështje që kanë të bëjnë me shkelje të të drejtave të individit për një proces të rregullt ligjor, Gjykata Kushtetuese duke iu referuar jurisprudencës së saj dhe të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, pranon legjitimitimin e individit kur ai ka interes për të mbrojtur të drejtat kushtetuese të cenuara nga një proces i parregullt. Lidhur me këtë, Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut shprehet në një vendim të saj se sipas nenit 1 të protokollit 1, mbrohet një pretendim legjitim dhe se në çështjen e paraqitur para saj, kërkesi kishte të paktën një pretendim të tillë.¹

Kushtetuta i jep të drejtën e nismës të kontrollit kushtetues, kujdo që pretendon për shkelje të të drejtave kushtetuese edhe atyre të mbrojtura nga konventa nëpërmjet një procesi të parregullt ligjor.

Nisur nga këto argumente, Gjykata Kushtetuese thekson se për më tepër, në çështjen në shqyrtim, kërkesit kanë fituar një të drejtë me vendim të formës së prerë dhe ajo nuk mund të preket pa një proces të rregullt ligjor.

2. Pretendimi tjetër i subjektit të interesuar lidhet me kërkesën kushtetuese të shterimit të mjeteve juridike për mbrojtjen e të drejtave, sipas nenit 131/f të Kushtetutës. Ky përcaktim kushtetues ka të bëjë me faktin se kontrolli i ushtruar nga Gjykata Kushtetuese përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit nga një proces i parregullt ligjor, është një kontroll subsidiar që do të thotë se individit duhet t'i ketë shterur mjetet dhe rrugët e tjera ligjore.

Juridiksioni kushtetues për shkelje të të drejtave themelore për një proces të rregullt, bëhet i mundur kur kërkesi të ketë shterur mjetet e ankimit pranë gjykatave të sistemit gjyqësor. Shterimi nënkupton që kërkesi duhet t'i shfrytëzojë në shkallët e sistemit gjyqësor të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të të drejtave të pretenduara. Mjete ligjore shterojnë kur në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi.

Sipas kriterit kushtetues të vlerësimit të çështjes lidhur me shterimin e mjeteve ligjore, Gjykata Kushtetuese çmon se përgjithësisht, nuk konsiderohen të shteruara mjetet ligjore kur për shkelje gjatë procedimeve të mëparshme, çështja është kthyer për rigjykim nga instanca më e lartë gjyqësore. Në këto raste, mungesa e legjitimitimit për të ushtruar ankim kushtetues lidhet dhe përcaktohet nga fakti se procesi vazhdon dhe ka ende mjete të tjera ankimi për të rivendosur të drejtën gjatë shqyrtimit të çështjes në gjykatat e sistemit gjyqësor.

Një situatë e ndryshme krijohet kur kërkesi pretendon se nuk janë respektuar kriteret e procesit të rregullt ligjor në instancën e fundit të gjykimit dhe nuk është parashikuar asnjë mjet ankimi ndaj vendimit të kësaj shkalje gjykimi. Në këto raste edhe pse çështja kthehet për rigjykim dhe procesi gjyqësor vazhdon, në aspektin e shterimit të mjeteve, ka rëndësi fakti se kërkesi nuk ka mjet tjetër ankimi ndaj shkeljeve të pretenduara në instancën e fundit të gjykimit dhe se shqyrtimi gjyqësor rishtazi, nuk pretendon t'i ndreqë këto shkaqe, por të gjykojë çështjen në themel. Në rrethana të tilla, është në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese të vlerësojë sipas karakterit të çështjes konkrete dhe llojit të shkeljeve të pretenduara, nëse kërkesi i ka shterur ose jo të gjitha mjetet ligjore për mbrojtjen e të drejtave të pretenduara.

Një qëndrim të tillë, lidhur me kriteret vlerësuese për shterimin e mjeteve, ka mbajtur edhe Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut në praktikën e saj. Në një vendim të saj kjo Gjykatë, në

1. Çështja Pine Valley kundër Irlandës, viti 1991

radhë të parë vuri në bisedim faktin e shterimit të mjeteve, duke përcaktuar se ky rregull nënkupton që kërkuksi t'u drejtohet mjeteve që janë efektive dhe të mjaftueshme për të realizuar ndreqjen e shkeljeve të lejuara.¹ Ajo nënvizon se ekzistenca e mjeteve në fjalë duhet të jetë me siguri e realizueshme, jo vetëm në teori por edhe në praktikë pa cenuar efektivitetin e domosdoshëm.

Nisur nga këto kritere kushtetuese dhe qëllimi që ato synojnë të arrijnë, Gjykata Kushtetuese vlerëson se në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi, për vetë rrethanat specifike të paraqitura, kur rishikimi është mjet i jashtëzakonshëm dhe vendimi i Gjykatës së Lartë është përfundimtar, kërkuksit nuk kanë mjet tjetër për të goditur vendimin që ka pranuar kërkesën për rishikim. Në këto rrethana, kërkuksit i kanë shterur të gjitha mjetet ligjore për mbrojtjen e të drejtave të tyre, prandaj pretendimet e ngritura në kërkesë duhet t'i nënshtrohen shqyrtimit kushtetues.

3. Shkaqet e parashtruara nga kërkuksit për proces të parregullt kanë të bëjnë me mungesën e komunikimit të kërkesës për rishikim dhe me shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit pa pjesëmarrjen e palëve. Këto dy shkelje të pretenduara nga kërkuksit janë të lidhura e të ndërvarura nga njëra-tjetra dhe kanë të bëjnë me standardet e caktuara për një proces të rregullt në drejtim të pjesëmarrjes në gjykim, të drejtës së mbrojtjes dhe parimit të kontradiktoritetit. Varësia dhe kompleksiteti i tyre kushtëzohen me faktin se nga domosdoshmëria e shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore me pjesëmarrjen e palëve dhe jo në dhomën e këshillimit, merr rëndësi dhe aspekti tjetër i shkeljes së pretenduar për mosnjohim të kërkesës për rishikim të vendimit. Në kushte normale të shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore, sipas përmbajtjes së nenit 447 të Kodit të Procedurës Civile, është e detyrueshme që palës së interesuar t'i njohetohet më parë kërkesa e paraqitur nga pala tjetër, me qëllim që t'i garantohet në kohë e drejta e mbrojtjes, të cilën do ta realizojë me pjesëmarrjen në gjykim.

Kërkesat e nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, të marra në tërësi, kanë për qëllim që t'i garantojnë kujtdo që pretendon se i janë shkelur të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj, në radhë të parë ndjekjen e çështjes në gjykatë. Në këtë kuptim, pjesëmarrja në gjykim është një e drejtë e pamohueshme për faktin se kjo pjesëmarrje shërben për të mbrojtur në substancë të drejtën që pretendohet si e shkelur.

Sipas një vendimi të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, do të ishte e pakuptimtë që neni 6/1 i Konventës të përshkruante me detaje garancitë procedurale që u ofrohen palëve në proces dhe të mos mbronte në radhë të parë atë që bën në të vërtetë të mundur që të përfitohet nga këto garanci dhe që është pjesëmarrja në gjyq.²

Kushtetuta dhe Konventa kanë përcaktuar standarte të qarta për pjesëmarrjen në gjykim dhe zhvillimin e procesit të rregullt ligjor në mënyrë të atillë që t'u garantohet të gjitha palëve mbrojtje efektive në të gjitha shkallët e gjykimit, prandaj prekja e tyre, përbën shkelje të të drejtave kushtetuese për një proces të rregullt ligjor.

Në kuptim të standardeve të vendosura nga Kushtetuta dhe Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, Gjykata Kushtetuese vlerëson se në shqyrtimin e çështjeve nga gjykatat e sistemit gjyqësor duhet të mos preken kriteret e procesit të rregullt, duke dalluar qëllimin dhe kompetencat e dhomës së këshillimit nga njëra anë dhe të seancës gjyqësore nga ana tjetër. Nga referimi në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile që parashikojnë shqyrtimin e rekursit dhe rishikimin e vendimeve del qartë se dhoma e këshillimit është një strukturë që shërben për shqyrtimin paraprak e seleksionimin e çështjeve, por jo për zgjidhjen e tyre në themel. Dhoma e këshillimit vendos për mospranimin e rekursit ose të kërkesës për rishikim, por nuk mund të vendosë për prishjen e vendimeve aq më tepër pa njohitur palën që ka fituar gjyqin.

Nga përmbajtja e dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, që kanë të bëjnë me rekursin dhe rishikimin, del se shqyrtimi në dhomën e këshillimit lidhet me mospranimin e tyre për t'u shqyrtuar nga gjykata, sepse nuk përmbushin kriteret ligjore. Në të kundërtën, kur këto kritere plotësohen, nuk mund të vendoset pranimi i kërkesës për rishikim dhe rekursit jashtë seancës gjyqësore dhe pa praninë e palëve. Aq më tepër pranimi i rishikimit pa kaluar çështjen në seancë për shkak të efekteve të mëdha që sjell si mjet i jashtëzakonshëm në ndryshim nga rekursi që është formë e zakonshme ankimi, e bën edhe më të qartë preken e standardeve dhe cenimin e procesit të rregullt ligjor. Rifillimi i procesit

1. Shih vendimin Akdivar, etj., kundër Turqisë, datë 16.9.1996

2. Çështja Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 21.2.1975

gjyqësor nga e para, pas një periudhe të caktuar kohe nga marrja formë e prerë e vendimit, pa u dhënë mundësi të barabarta palëve për të shprehur e mbrojtur pretendimet e tyre, del haptazi jashtë kufijve të procesit të rregullt në kuptim të Kushtetutës dhe Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Çdo provë e paraqitur nga pala që pretendon se mund të çojë në rihapjen e procesit gjyqësor duhet t'i nënshtrohet shqyrtimit sipas parimit të kontradiktoritetit, duke i dhënë mundësi palës tjetër për të shprehur pretendimet e saj, sepse ajo nuk mund të privohet arbitrarisht nga e drejta që i është njohur me vendim të formës së prerë të gjykatave. Në raste të tilla, standardi minimal që duhet t'i garantohet palës respektive, është shansi i barabartë për të qenë e pranishme në një proces ku do të shqyrtohet pozita e saj juridike.

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut në një sërë vendimesh të saj ka theksuar se Konventa nuk ka për qëllim të mbrojë të drejtat në mënyrë teorike dhe zhgënjyese, por të garantojë të drejta praktike dhe të efektshme, sidomos përsa i përket të drejtës për t'u paraqitur para një gjykate.¹ Duke folur për respektimin e kërkesave për “barazinë” e armëve si aspekt i procesit të rregullt, Gjykata e Strasburgut shprehet se në konfliktin në të cilin ndërthurren interesa të kundërta private, ky lloj “barazimi armësh” do të thotë që secilës palë duhet t'i sigurohen mundësitë përkatëse për t'i parashtruar çështjet e saj në kushte që nuk e vënë atë në gjendje shumë më pak të favorshme se sa palën e kundërt”.²

Seanca e hapur gjyqësore përbën një tipar thelbësor të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Karakteri i hapur i procedimeve para organeve gjyqësore sipas nenit 6/1 të Konventës mbron palët ndërgjyqëse kundrejt ushtrimit të drejtësisë në fshehtësi dhe pa mbikëqyrje publike. Publiciteti në ushtrimin e drejtësisë kontribuon në përmbushjen e synimit për një proces të drejtë gjyqësor, garantimi i të cilit përbën një nga parimet themelore të një shoqërie demokratike.³

Bazuar në këto argumente, kërkesa për rishikim është një mjet ankimi dhe duhet t'i njoftohet palës tjetër sipas rregullave të përgjithshme aq më tepër që ky mjet përbën në vetvete një kërkesë të re për të cilën, pala e interesuar, jo vetëm që nuk ka dijeni, por është akoma nën përfytyrimin e realizimit konkret të së drejtës së fituar.

Barazia në mjete dhe e drejta për t'u vënë në dijeni për faktet dhe argumentet e palës kundërshtare, përbëjnë aspekte të procesit të rregullt. Kjo nënkupton që çdo palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e vet dhe asnjë palë nuk duhet të gëzojë ndonjë avantazh të konsiderueshëm ndaj kundërshtarit, por duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë midis palëve.⁴

E drejta për proces të rregullt përfshin gjithashtu edhe nocionin se të dyja palët në një proces kanë të drejtë të kenë informacion për faktet dhe argumentet e palës kundërshtare, që nënkupton në parim mundësinë për palët në një seancë civile apo penale të kenë njohuri edhe për komentet mbi provat e nxjerra.⁵

Nga ana tjetër, duke marrë parasysh natyrën e shqyrtimit të çështjes në rastet e rishikimit, e cila ka të bëjë jo vetëm me konstatimin e fakteve, por edhe me vlerësim të tyre (shkronja “a, b, e” të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile), atëherë ky vlerësim duhet të bëhet nga gjykata, pasi të ketë zbatuar parimin e kontradiktoritetit në gjykim. Ky moment ka rëndësi, sepse nuk mund të prishen vendimet në dhomën e këshillimit duke prekur standardet e procesit të rregullt ligjor.

Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj ka bërë të qartë dallimin midis shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit dhe rasteve kur shqyrtimi duhet të bëhet detyrimisht në seancë, ndryshe preken standardet e procesit të rregullt. Në vendimin e saj nr.6, datë 26.2.2003, duke iu referuar çështjes konkrete në zbatim të dispozitave procedurale që parashikojnë ushtrimin e rekursit dhe kërkesës për rishikim, thuhet se shqyrtimi i kërkesës nga Gjykata e Lartë, kur ajo është bërë jashtë

1. Shih çështjen Airey kundër Irlandës

2. Shih çështjen Dombo Behere kundër Holandës, V, 27.10.1993 dhe Stratis Andreadis kundër Greqisë V, 9.12.1994.

3. Vendimi i Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, Axen kundër Republikës Federale të Gjermanisë, datë 8.12.1983

4. Shih çështjen Dehaes dhe Giples kundër Belgjikës, v.24.2.1997

5. Çështja Ruiz-Mateos, kundër Spanjës, v.23.6.1993

kritereve ligjore, bëhet në dhomën e këshillimit pa pjesëmarrjen e palëve.

Nëpërmjet arsytimit të këtij vendimi bëhet mirë dallimi mes kompetencave të dhomës së këshillimit, kur kërkesa nuk përmban kritere ose shkaqe ligjore dhe në të kundërt, kur shkaqet ligjore ekzistojnë dhe provohen si të tilla nga gjykata, shqyrtimi i çështjes nuk mund të bëhet më në dhomën e këshillimit, por në seancë gjyqësore, përndryshe një shqyrtim i tillë është antikushtetues.

Në çështjen në shqyrtim, ashtu siç pretendohet edhe nga kërkuesit, Gjykata Kushtetuese konstaton se nga ana e Gjykatës së Lartë është pranuar kërkesa për rishikim të vendimit duke u vlerësuar si të reja provat e paraqitura, dhe në kundërshtim me të gjitha standardet e procesit të rregullt ligjor, çështja është zgjidhur në dhomën e këshillimit. Në këtë mënyrë procesi i zhvilluar është i parregullt gjë që e bën vendimin antikushtetues.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/f e 134/g të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e 77 të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.17, datë 10.3.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM

Nr.18, datë 19.7.2005

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 17.1.2005, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.25/5 Akti që i përket:

KËRKUES: KUJTIM ÇASHKU, përfaqësuar nga avokat Viktor Konomi, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. NEZIR E SHPËTIM STËRMASI, përfaqësuar nga avokat Edmond Hicka, me prokurë të posaçme.
2. NERMIN STERMASI, në mungesë.
3. ALAUDIN, LUMTURI, SHYRETE, YLLKA, HAMZA E PRANVERA BOKSI,

përfaqësuar nga avokat Enver Qafmolla, me prokurë.

4. KOMISIONI I KTHIMIT DHE I KOMPENSIMIT TË PRONAVE, TIRANË

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.304, datë 13.1.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Pala kërkuese ka parashtruar këto shkaqe për papajtueshmërinë me Kushtetutën të vendimit të mësipërm:

- Kolegji Civil ka shkelur parimin e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, të parashikuar nga neni 42/2 i Kushtetutës. Zvarritja e gjykimit favorizon palën e paditur, duke shkelur kështu edhe parimin e gjykimit nga një gjykatë e paanshme;

- Në këtë gjykim është shkelur edhe parimi i gjykatës kompetente, sepse ky parim përfshin edhe gjykimin me kompetencë profesionale;

- Gjykata e Lartë, ka marrë atributet e një gjykate fakti, duke dalë jashtë natyrës së saj si gjykatë e ligjit.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Petrit Plloçi, përfaqësuesit e kërkuesit, të subjekteve të interesuara dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Me vendimin nr.1348, datë 14.12.2001, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka prishur vendimin nr.4, datë 26.7.2000 të Gjykatës së Apelit, Tiranë dhe e ka dërguar çështjen për rigjykim po në këtë gjykatë me tjetër trup gjykues.

Gjykata e Apelit, Tiranë, me vendimin nr.17, datë 16.9.2002, ka vendosur lejimin e pjesëtimit të dy trojeve, respektivisht prej 651 m² dhe 48 m², si dhe të një banese dykatëshe, prona këto të ndodhura në Rr. "Q.Stafa", Tiranë, në mënyrën siç përshkruhet në pjesën urdhëruese të këtij vendimi.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.304, datë 13.1.2004, ka vendosur prishjen e vendimit të mësipërm të Gjykatës së Apelit, Tiranë dhe pushimin e gjykimit të çështjes.

Vendimin e Kolegjit Civil, kërkuesi e konsideron si rrjedhojë e një procesi jo të rregullt ligjor.

Gjykata Kushtetuese, duke marrë parasysh të dhënat lidhur më sa më sipër, vlerëson se, në kuptimin që i jep të drejtës për një proces të rregullt ligjor neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, pretendimet e kërkuesit janë të pabazuara.

Me këtë rast, Gjykata Kushtetuese rithekson se, e drejta për një proces të rregullt ligjor, luan rol qendror në sistemin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Realizimi i kësaj të drejte shfaqet në aspekte të ndryshme, ndërmjet të cilave, një vend të rëndësishëm zë edhe respektimi i parimeve të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur, e paanshme, e caktuar me ligj.

Për të verifikuar nëse është shkelur parimi i gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, Gjykata Kushtetuese e sheh me vend të aplikojë kriteret që ka zhvilluar Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut, e cila në këtë drejtim ka adaptuar një trajtim *in concreto*, duke u shprehur se, "arsyeshmëria e zgjatjes së procesit duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të veçanta të çështjes, duke pasur parasysh, sidomos, kompleksitetin e çështjes, sjelljen e aplikantit, si dhe sjelljen e autoriteteve kompetente"¹

Duke shqyrtuar materialet e dosjes, si dhe parashtrimet në ankim gjatë seancës, Gjykata arrin në konkluzionin se në rastin në shqyrtim, nuk vërtetohet shkelje e parimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm.

Gjykata Kushtetuese vëren se, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë pasur për shqyrtim një çështje civile komplekse. Konkretisht, konstatohet se këtyre gjykatave u janë paraqitur një padi dhe një kundërpadi dhe në gjykim kanë marrë pjesë një numër i madh palësh, të cilat kanë paraqitur një sërë pretendimesh. Përveç sa më sipër, në zgjatjen e procesit ka ndikuar edhe fakti se kjo çështje,

1. Vendimi Kemmache v. France, i 27 Nëntor 1991, paragr.60.

mbi bazën e ankimeve, ka kaluar dy herë të gjitha instancat gjyqësore.

Gjykata Kushtetuese vlerëson gjithashtu se, edhe pretendimi për shkeljen e parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, i cili sipas tij, përfshin edhe gjykimin me kompetencë profesionale, nuk u provua nga shqyrtimi i çështjes.

Lidhur me nocionin gjykatë e caktuar me ligj, Gjykata Kushtetuese konstaton se, kjo shprehje mbulon jo vetëm bazën ligjore për vetë ekzistencën e kësaj gjykate, por në çdo rast edhe mënyrën e formimit të trupit gjykues.¹ Në këtë vështrim, në asnjërin prej këtyre aspekteve kërkuesi nuk ka pasur pretendime. Për pasojë, Gjykata Kushtetuese vlerëson se, në rast se një gjykatë plotëson kriteret e mësipërme të një gjykate të caktuar me ligj, atëherë natyrshëm prezumohet aftësia profesionale e gjyqtarëve, të cilët janë në përbërje të kësaj gjykate.

Kërkuesi ka pretenduar gjithashtu se, në rastin në shqyrtim, Gjykata e Lartë ka marrë atributet e një gjykate fakti. Gjykata Kushtetuese konstaton se edhe ky pretendim nuk është i bazuar. Në rastin konkret, Gjykata e Lartë bazuar në dispozitat procedurale civile (neni 485/e) ka vendosur pushimin e gjykimit. Për pasojë, kjo Gjykatë ka bërë një vlerësim ligjor të rasteve të pushimit të gjykimit, gjë që është në natyrën e gjykimit që bëhet në këtë instancë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/f dhe 134/g të Kushtetutës si dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS

Për zgjidhjen e çështjes me kërkues zotin Kujtim Çashku, kam mendim të ndryshëm nga ai i shumicës. Shumica duhej ta vlerësonte të pranueshëm pretendimin e parashtruar nga kërkuesi për dhunim të së drejtës kushtetuese për gjykimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm, si një element të procesit të rregullt ligjor.

Në nenin 42, paragrafi 2 të Kushtetutës, sanksionohet se “Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetuese dhe ligjore ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.”

Koncepti kushtetues i afatit të arsyeshëm është i sanksionuar, gjithashtu edhe në nenin 6, paragrafi 1 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Sikundër është pretenduar nga kërkuesi, gjë që rezulton edhe nga aktet e dosjes gjyqësore, procedurat gjyqësore në këtë çështje kanë zgjatur për një kohë relativisht të gjatë. Padia nga pala kërkuese është ngritur para gjykatës kompetente në vitin 1996 dhe pikërisht atëherë, kur gjykata e apelit dha përfundimisht vendimin nr.17, datë 16.9.2002, që zgjidhte konfliktin në mes palëve. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 19.1.2004 prishi vendimin e gjykatës së apelit dhe vendosi pushimin e gjykimit të çështjes.

Me këtë zgjidhje të bërë nga Gjykata e Lartë, mosmarrëveshja civile midis palëve të këtij gjykimi ka mbetur e pazgjidhur, sepse procedurat gjyqësore të zhvilluara për afro 10 vjet nuk kanë vlerë dhe se pala e interesuar (kërkuesit), megjithëse i duhet të nisë procedurat gjyqësore nga e para, përsëri nuk do të realizojë të drejtën e tij, sepse nuk ka prova të tjera, veç atyre që kish paraqitur në gjykimin e mëparshëm. Për rrjedhojë, kjo humbje kohe, sikurse pretendon kërkuesi, i ka sjellë atij privimin e së drejtës për të zotëruar dhe përdorur pronën e vet.

Në rastin në gjykim, edhe pse çështja deri diku ka qenë e komplikuar dhe palët, veçanërisht

1. Vendim i GJ.E.D.NJ. në çështjen *Posokhov v. Russia*, i dt.4.6.2003, parag.39.

pala kërkuese, nuk kanë dhënë shkak për zvarritje të pajustificuara të procesit gjyqësor, vonesa në zgjidhjen e çështjes ka ardhur kryesisht si pasojë e kalimeve të saj nga gjykata e apelit në Gjykatën e Lartë dhe anasjelltas. Është e vërtetë se ankimet janë ushtruar nga palët, por këto nuk kanë pasur qëllim zvarritjen e procesit, por faktin se ishin të pakënaqura nga zgjidhjet e bëra nga gjykata.

Zvarritja e gjykimit të çështjes është bërë nga Gjykata e Lartë. Kjo gjykatë arrin në përfundimin se gjykata e apelit duhej të kishte vendosur pushimin e gjykimit të çështjes në kushtet, kur nuk kishte asnjë pengesë nga ligji procedural që këtë ta vendoste vetë qysh në gjykimin e parë.

Edhe në rigjykim, Gjykata e Lartë duhej të zgjidhte çështjen përfundimisht e jo të vendoste pushimin e gjykimit, pasi palët, veç provave të paraqitura, nuk kishin prova të tjera dhe sikundër pranohet në vendimin e saj, bazuar në dokumentin hipotekor, palët janë bashkëpronarë të truallit mbi të cilin është ngritur një shtëpi banimi para vitit 1932 dhe për pasojë, ata janë bashkëpronarë të gjithçkaje që ngrihet mbi të, pra, edhe mbi ndërtesën e banimit, të cilën e zotërojnë dhe administrojnë që nga ajo kohë qetësisht dhe pa ndonjë pretendim nga persona të tjerë.

Nga ky këndvështrim, kuptohet qartë se zvarritja dhe ndërlikimet janë rrjedhojë e mënyrës se si gjykata ka administruar çështjen konkrete, pa pasur parasysh kërkesën e Kushtetutës dhe të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, për respektimin e afatit të arsyeshëm si një komponent i procesit të rregullt ligjor.

Prandaj, vendimi i Gjykatës Kushtetuese duhej të ishte i tillë, që të ndërpriste vazhdimin e shkeljes kushtetuese, duke e cilësuar procesin e parregullt, gjë që do të evitonte një kohëzgjatje tjetër të pajustificuar për përfundimin e këtij procesi gjyqësor.

KRYETAR
Gj. Sauli

VENDIM
Nr.19, datë 19.7.2005

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 8.2.2005, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.17 Akti që i përket:

KËRKUESI: HYSEN KALAJA, përfaqësuar nga avokatët Rustem Gjata, me deklaram e Liljana Ruli, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: 1. MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE, përfaqësuar nga Avokati i Shtetit Delo Isufi, me autorizim.

2. INSTITUTI I MONUMENTEVE TË KULTURËS, përfaqësuar nga Avokati i Shtetit Delo Isufi, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimeve nr.470, datë 15.4.2002 të Gjykatës së Apelit, Tiranë dhe nr.1034, datë 3.6.2003 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhoma e këshillimit).

Pala kërkuese ka parashtruar këto shkaqe për papajtueshmërinë me Kushtetutën të vendimit të mësipërm:

Gjykatat kanë shkelur të drejtën për një proces të rregullt ligjor:

- Gjykata e apelit, ka marrë përsipër të kryejë rolin e ekspertit, ndërkohë që, në bazë të nenit 229 të Kodit të Procedurës Civile, duhet të urdhëronte kryerjen e një ekspertimi të ri;

- Gjykata e apelit ka shkelur parimin e barazisë së armëve (palëve), sepse për përcaktimin e vlerës së objektit është mbështetur në praktikën e Institutit të Monumenteve të Kulturës;
- Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke mos e kaluar çështjen për shqyrtim në seancë plenare na ka mohuar mundësinë për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e ligjshme në gjykatë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Petrit Plloçi, përfaqësuesit e kërkuessit, të subjekteve të interesuara dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Me vendimin nr.336, datë 25.7.2001, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë ka vendosur rrëzimin e padisë së paditësit Hamid Kalaja, përse i përket shfuqizimit të vendimit nr.292, datë 2.6.2000 të Këshillit të Ministrave “Për shpronësimin për interes publik të godinës aktuale të Muzeut Etnografik në qytetin e Krujës”, dhe pranimin pjesërisht të padisë lidhur me pagimin e shpërblimit për shpronësimin e Muzeut Etnografik, Krujë, duke detyruar të paditurit: Ministria e Kulturës, Rinisë dhe e Sporteve dhe Instituti i Monumenteve të Kulturës, t’i paguajnë paditësit Hamid Kalaja vlerën e objektit Muzeu Etnografik Krujë, në shumën 900.000 USD e konvertuar në lekë sipas kursit që ekziston në ditën e shpalljes së vendimit.

Me vendimin nr.470, datë 15.4.2002 Gjykata e Apelit Tiranë, ka vendosur: Ndryshimin e vendimit nr.336, datë 25.7.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Krujë, duke pranuar pjesërisht padinë, duke detyruar Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Institutin e Monumenteve të Kulturës t’i paguajnë paditësit Hamid Kalaja shumën 18 595 615 lekë për vlerën e objektit të shpronësuar.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr.1034, datë 3.6.2003 ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga Hamid Kalaja.

Vendimet e mësipërme të gjykatës së apelit, si dhe të kolegjit civil, kërkuessi i konsideron si rrjedhojë e një procesi jo të rregullt ligjor, gjë që shfaqet në drejtim të shkeljes së parimit të barazisë së palëve në proces, si dhe në atë të marrjes së provave në mënyrë të paligjshme.

Në kuadrin e shqyrtimit të këtyre pretendimeve, Gjykata Kushtetuese afirmon edhe një herë qëndrimin e saj se, parimi i barazisë së armëve, si dhe marrja e provave në mënyrë të ligjshme, përbëjnë aspekte të rëndësishme të respektimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, si dhe neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Në këtë drejtim “detyra e gjykatës është të vlerësojë nëse procesi si i tërë, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave, ka qenë i drejtë”.¹

Lidhur me pretendimin për shkeljen e parimit të barazisë së armëve, pala kërkuese e gjen shkeljen në faktin se, gjykata e apelit në përcaktimin e vlerës ... së objektit monument kulture, udhëhiqet nga qëndrimet e praktikës së Institutit të Monumenteve të Kulturës, megjithëse ky Institut ka qenë palë në proces.

Bazuar në materialet e çështjes, Gjykata Kushtetuese konstaton se, në rastin konkret, gjykatat e zakonshme kanë pasur për shqyrtim një konflikt administrativ që ka të bëjë me kundërshtimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.292, datë 2.6.2000 “Për shpronësimin e Muzeut Etnografik, Krujë”, vetëm përse i përket vlerës së objektit që i është shpronësuar kërkuessit. Për përcaktimin e vlerës së objektit të shpronësuar Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Krujë, në bazë të neneve 224/a e vijues të Kodit të Procedurës Civile, ka caktuar dy grupe ekspertësh, të cilët kanë bërë vlerësimin e objektit në 900 mijë USD, duke u mbështetur në vlerën ndërtimore dhe vlerën arkitektonike e historike. Gjykata e Apelit Tiranë, ka përsëritur hetimin gjyqësor, duke ripyetur ekspertët që ka marrë gjykata e rrethit gjyqësor. Pas ripyetjes së tyre, në vendimin e saj gjykata e apelit shprehet se, ata (ekspertët) nuk kanë përcaktuar se si kanë arritur në këtë përfundim. Për pasojë, duke pasur mendim të kundërt me atë të ekspertëve përse i përket vlerës arkitektonike e historike të objektit, gjykata e apelit ka aplikuar nenin 224/b/2, sipas të cilit *mendimi i ekspertit nuk është i detyrueshëm për gjykatën, dhe kur kjo (gjykata) ka mendim të kundërt me ekspertin duhet të arsyetojë me hollësi këtë mendim në vendimin përfundimtar*. Në përputhje me këtë dispozitë, gjykata e apelit ka arsyetuar në vendimin përfundimtar

1. Vendim i GJ.E.D.NJ. në çështjen *Isgro*, paragrafi 31.

pozicionin e ndryshëm me ekspertët, duke përcaktuar një vlerë tjetër për objektin.

Veç sa sipër, Gjykata Kushtetuese vëren se, parimi i barazisë së armëve nuk u imponon gjykatave të juridiksionit të zakonshëm që këto të pranojnë të gjitha argumentet dhe provat që paraqet një palë në proces. Kur kryen detyrën e saj të vlerësimit të lirë të provave, gjykata mund të bindet mbi bazën e disa provave, duke përjashtuar një ose disa prova të tjera, që ajo i konsideron të parëndësishme për çështjen. Në zbatim të këtij standardi, edhe në rastin në shqyrtim, gjykata e apelit në arritjen e një konkluzioni të ndryshëm nga ai i ekspertëve, lidhur me vlerën e objektit të shpronësuar, brenda hapësirave që i lejon Kodi i Procedurës Civile, nuk ka cenuar parimin e barazisë së armëve.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se, edhe pretendimi i marrjes së provave në mënyrë të paligjshme, nuk qëndron. Nisur nga parimi i sipërpërmendur i lirisë së gjykatës në vlerësimin e provave, neni 224b/2 i Kodit të Procedurës Civile trajton vlerën provuese të mendimit të ekspertit, ndërsa neni 229 i po këtij Kodi, rregullon mënyrën e procedimit të gjykatës në rastet kur shihet se ekspertimi është i metë ose i paqartë, si dhe kur ka ndryshim mendimesh midis ekspertëve. Siç shihet, këto dy dispozita ofrojnë alternativa procedimi, zgjedhja e të cilave është lënë në vlerësim të gjykatave të zakonshme. Në rastin në shqyrtim, gjykata e apelit, duke zgjedhur alternativën e parë, pra, atë që parashikon neni 224b/2 i Kodit të Procedurës Civile, pas një vlerësimi në tërësi të provave dhe të rrethanave të çështjes, si dhe duke përmbushur kushtin e vendosur në këtë dispozitë për arsyetimin me hollësi, ka arritur në një mendim të ndryshëm me atë të ekspertëve. Duke vepruar në këtë mënyrë, kjo gjykatë ka respektuar dispozitat përkatëse procedurale për marrjen e provave.

Edhe pretendimi se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke mos e kaluar çështjen në seancë gjyqësore, i ka mohuar kërkuar mundësinë për të mbrojtur të drejtat e tij në gjykatë, nuk është i bazuar.

Me këtë rast, Gjykata Kushtetuese konfirmon edhe një herë pozicionin e saj në këtë drejtim, se nga pikëpamja kushtetuese, vetëm kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit civil, si dhe kur këto pretendime, gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, atëherë vendimi i kolegjit civil për mospranimin e rekursit, vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Detyrimi për të provuar ekzistencën e shkeljeve të kësaj natyre bie mbi kërkuar. Përderisa në rastin në shqyrtim ky i fundit nuk arriti ta provojë këtë, atëherë nuk mund të konkludohet se vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhoma e këshillimit) është rezultat i një procesi të parregullt ligjor.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/f dhe 134/g të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM

Nr.20, datë 20.7.2005

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “

Vjollca Mecaj	Anëtare e	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar i	“	“
Petrit Plloçi	Anëtar i	“	“
Sokol Sadushi	Anëtar i	“	“
Kristofor Peçi	Anëtar i	“	“

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 9.3.2005, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.24 Akti që i përket:

KËRKUESI: KUJDESI KURPALI, përfaqësuar nga avokatët Viktor Konomi e Qazim Gjonaj, me prokurë.

SUBJEKTI I INTERESUAR: PROKURORIA E PËRGJITHSHME, përfaqësuar nga zoti Artur Selmani, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetuese të vendimeve nr.98, datë 18.9.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, nr.172, datë 16.9.2003 të Gjykatës së Apelit, Shkodër dhe nr.146, datë 2.3.2004 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f e 134/g të Kushtetutës, si dhe nenet 27 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

Kërkuesi pretendon për zhvillim të procesit të parregullt ligjor në këto drejtime kryesore:

1. Hetimi dhe gjykimi i çështjes është bërë në mungesë të të pandehurit dhe pa pasur dijeni për procedimin;

2. Vendimi i njoftimit të akuzës dhe procesverbali për njohjen e materialeve të çështjes nuk i janë komunikuar avokatit; hetimet kanë zgjatur për një periudhë mbi 6 muaj tej afatit ligjor pa vendim të prokurorit për zgjatje të afatit; këto akte janë absolutisht të pavlefshme;

3. Nuk ka ekspertim mjekoligjor për të përcaktuar shkakun e vdekjes dhe nuk është hetuar nëse vdekja ka ardhur për shkak të plagëve apo nga mosdhënia e ndihmës;

4. Shkaqet e pretenduara e detyruan gjykatën e apelit të merrte vendim të ndërmjetëm për përsëritje të pjesëshme të hetimit gjyqësor, por në seancën e mëpasme, po kjo gjykatë, vendosi përfundimin e gjykimit pa kryer hetimet për të cilat vendosi në seancën e mëparshme;

5. Të gjitha këto shkelje, si dhe pretendimi për kualifikim të gabuar të veprës iu bënë prezent në rekurs Gjykatës së Lartë, por Kolegji Penal vendosi në dhomën e këshillimit, mospranimin e rekursit.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin Kristofor Peçi, përfaqësuesit e kërkuesit, përfaqësuesin e subjektit të interesuar, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Me vendimin nr.98, datë 18.9.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Kukës, kërkuesi K.Kurpali, është deklaruar fajtor për veprën penale të vrasjes me paramendim dhe atë të armëmbajtjes pa leje në bazë të neneve 78 e 278/2 të Kodit Penal dhe është dënuar me 20 vjet burgim.

Kërkuesi, duke pretenduar se nuk ka qenë në dijeni të procedimit dhe dënimit, ka kërkuar të rivendoset në afat për të ushtruar ankim. Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Kukës me vendimin nr.2, datë 15.5.2003 e ka rivendosur në afat. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr.172, datë 16.9.2003 ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.146, datë 2.3.2004, ka vendosur në dhomën e këshillimit mospranimin e rekursit.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se shkaqet që ngrihen nga kërkuesi në kërkesën e tij, kanë të bëjnë me shkelje të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor në disa drejtime:

1. Është shkelur parimi kushtetues që garanton të drejtën e mbrojtjes në hetimet paraprake. Vërtetohet se kërkuesi është hetuar e gjykuar në mungesë. Hetimi i çështjes ka filluar në datën 10.6.1997, dhe deri në datën 25.3.1998 nuk është caktuar avokat në mungesë, për mbrojtjen e të pandehurit. Vendimi për njoftimin e akuzës mban datën 13.2.1998, por nuk i është komunikuar

avokatit, sepse deri në këtë datë nuk ishte caktuar avokat mbrojtës. Edhe procesverbali mbi njohjen e materialeve të çështjes, vendimi për dërgimin e çështjes në gjykatë dhe kërkesa për gjykim nuk rezultojnë t'i jenë njoftuar avokatit.

Këto veprime të kryera në fazën e hetimeve paraprake i kanë mohuar krejtësisht të pandehurit të drejtën e mbrojtjes, duke cenuar standardet kushtetuese dhe ato të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Veç këtyre rezultojnë se janë lejuar edhe shkelje të tjera të rënda procedurale. Kështu, çështja penale është filluar në datën 10.6.1997 dhe është dërguar në gjyq në datën 30.3.1998. Hetimet kanë vazhduar tej afatit të përcaktuar në ligj pa vendim të prokurorit për zgjatje të afatit e për rrjedhojë, pa iu komunikuar një zgjatje e tillë të pandehurit ose mbrojtësit të tij. Në bazë të nenit 323 të Kodit të Procedurës Penale, brenda 3 muajve nga data në të cilën emri i personit që i atribuohet vepra penale është shënuar në regjistrin e njoftimeve, prokurori duhet të vendosë dërgimin e çështjes në gjyq, pushimin ose pezullimin e saj. Në bazë të nenit 325/1 të Kodit të Procedurës Penale, i pandehuri ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatë ndaj vendimit të prokurorit për zgjatjen e afatit të hetimeve. Në rastin konkret duke vazhduar hetimet për një periudhë rreth 6 muaj, pa pasur vendim për zgjatje të afatit nga prokurori, janë shkelur të drejtat e të pandehurit, të garantuara nga Kushtetuta dhe ligji.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Kukës, ka shqyrtuar çështjen në rrethana të tilla kur në hetimet paraprake është shkelur parimi kushtetues që garanton të drejtën e mbrojtjes.

Sipas nenit 151/1 të Kodit të Procedurës Penale, gjatë hetimeve paraprake provat merren nga organi që procedon sipas rregullave të përcaktuara në këtë Kod. Ndërsa në pikën 4 të këtij neni, përcaktohet se provat e marra në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji nuk mund të përdoren. Papërdorshmëria ngrihet edhe kryesisht në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit. Gjykata e shkallës së parë, në shqyrtimin gjyqësor të çështjes ka vepruar në kundërshtim me këto rregulla, duke e bërë kështu procesin gjyqësor të parregullt.

3. Gjykata e apelit, duke marrë në konsideratë pretendimet e ngritura nga avokati i kërkuarit për hetim dhe gjykim të pamjaftueshëm, në seancën e datës 15.7.2003, me vendim të ndërmjetëm ka riçelur seancën gjyqësore për përsëritjen e pjesshme të hetimit gjyqësor, duke kërkuar: fashikullin e hetimeve paraprake, vendimin e gjykatës për caktimin e masës së sigurimit për të pandehurin dhe certifikatën e gjendjes civile. Por, në seancën e datës 16.9.2003, kjo gjykatë vendosi përfundimin e gjykimit pa i kryer hetimet për të cilat kishte vendosur në seancën e mëparshme. Në këtë mënyrë edhe kjo Gjykatë është pajtuar dhe ka lënë në fuqi shkeljet e kryera në procedimet e mëparshme si të hetimit paraprak, ashtu edhe të gjykimit të çështjes.

4. Shkeljet si më sipër kërkuar i ka ngritur në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë. Gjykata Kushtetuese vlerëson se në rastin konkret këto shkelje kanë të bëjnë drejtpërdrejt me të drejtat themelore të garantuara nga Kushtetuta lidhur me procesin e rregullt ligjor, prandaj Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ishte rasti që ta kalonte çështjen në seancë, duke zbatuar parimin e kontradiktoritetit në gjykim.

Të gjitha këto shkelje të pretenduara nga kërkuari dhe të verifikuara gjatë shqyrtimit të çështjes kanë të bëjnë me prekljen e standardeve të rëndësishme të procesit penal, për të cilat Gjykata Kushtetuese është shprehur edhe në vendimet e saj të mëparshme, duke i shfuqizuar vendimet përkatëse si antikushtetuese.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/f e 134/g të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e 77 të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si antikushtetuese të vendimeve nr.98, datë 18.9.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Kukës; nr.172, datë 16.9.2003 të Gjykatës së Apelit Shkodër, dhe nr.146, datë 2.3.2004 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Kukës.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren

Zyrtare.

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;

- Qendrës së Publikimeve Zyrtare:

Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".

Tel: 042 555 63; 267 468

Për çdo lloj informacioni, shihni faqen e internetit në adresën:

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

BOTIMET:

1. KUSHTETUTA (edhe anglisht)
2. KODI I PROCEDURËS CIVILE
3. KODI I PROCEDURËS PENALE
4. KODI PENAL
5. KODI I PUNËS
6. KODI I FAMILJES
7. KODI CIVIL
8. KODI RRUGOR DHE LIGJI PËR TRANSPORTIN
9. KODI ZGJEDHOR (i azhurnuar)
10. KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE
11. DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:

1. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT
2. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK
3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË
5. PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE

DOLI NGA SHTYPI:

TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004

TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004

Doli nga shtypi më 24.7.2005

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2005

Çmimi 150 lekë